



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 129, datë 27.04.2021

**MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS PËR PROKURORIN GENTI XHOLI, KANDIDAT PËR POZICIONIN E DREJTUESIT TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË APELIT TIRANË**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 159, pika 1 dhe 2 germa "a", 184 dhe 189, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenin 52, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në pikën 5, të nenit 9, të Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm", miratuar me Vendimin nr. 200, datë 23.09.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe në germën "ç", pika 8, Seksioni Ç, të Kreut VI, të Rregullores "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve", miratuar me Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019 e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i ndryshuar si dhe pasi u njoh me Relacionin "Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës për prokurorin Genti Xholi, kandidat për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë", Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për prokurorin Genti Xholi, kandidat për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidatit prokuror Genti Xholi të vijojë me procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
3. Të njoftohet për këtë vendim z. Genti Xholi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR  
GENT IBRAHIMI


ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA



**ANËTAR  
KOSTAQ BELURI**



**ANËTAR  
BUJAR SHESHI**



**ANËTAR  
NURIHAN SEITI**



**ANËTAR  
SANDËR BECI**



**ANËTAR  
VATË STAKA**



**ANËTAR  
TARTAR BAZAJ**

**ANËTAR  
ESMERALDA KESHI**



**ANËTAR  
ELOIDA GOXHI**



**ANËTAR  
MOISI DUDA**

